

**UDHËZUES OPERACIONAL
PËR IMPLEMENTIMIN E PROJEKTIT**

“MBËSHTETJE FINANCIARE (GRANT) PËR BIZNESE TË REJA “TË GJELBËRTA” TË CILAT BAZOHEN NË NJË MODEL EKO-MIQËSOR, OSE BIZNESE EKZISTUESE TË CILAT TENTOJNË TË SHNDËRROHEN NË BIZNESE “TË GJELBËRTA” DUKE FUTUR ELEMENTË GO-GREEN NË TO”

PËRMBAJTJA:

PROJEKT PROPOZIMI

- 1. Hyrje**
- 2. Qëllimi dhe Objektivat**
- 3. Përfitimet e projektit**
- 4. Buxheti**

UDHËZUES OPERACIONAL

- 1. Çfarë është Granti për Bizneset e Gjellërta?**
- 2. Mbështetja financiare**
- 3. Aplikantët e pranueshëm**
- 4. Shpenzimet që mund të mbulohen nga skema**
- 5. Mbulimi gjeografik**
- 6. Organet e Projektit dhe detyrat e tyre**
- 7. Mënyra e procedimit të Skemës së Grantit**
- 8. Kontraktimi dhe mënyra e pagesës së Grantit**
- 9. Monitorimi i projektit**
- 10. Konfidencialiteti i të dhënave**
- 11. Anekset e projektit**

PROJEKT PROPOZIM

Hyrje

Sfidat e shkaktuara nga ndryshimi global i klimës, kanë bërë që vëmendja e të gjitha vendeve të botës, të kthehet drejt konsumit dhe prodhimit të qëndrueshëm si një domosdoshmëri për mirëqenien e punëtorëve, ndërmarrjeve dhe ekonomive në tërësi. Konsensusi global mbi rëndësinë kritike të një reagimi më të madh ndaj mjedisit, reflektohet në të gjitha agjendat e qeverive në të gjithë botën.

Krijimi i një modeli bazuar në Ekonominë e Gjelbër është shumë i rëndësishëm në ditët e sotme, sepse rritja ekonomike duhet të mundësohet pa dëmtuar mjedisin. Në një model të tillë duhet të kryhet menaxhimi sa më i mirë i burimeve, instrumenteve ekonomike që janë të mira për mjedisin, mbështetjen e inovacionit, politikave më të mira për ujë dhe mbeturinave si dhe përpjekjeve për të rritur konsumin dhe prodhimin e qëndrueshëm.

Bizneset e gjelbërta kanë një rol kryesor në këtë. Ndërsa bizneset e gjelbërta kursejnë burime të pakta, ndihmojnë në mirëmbajtjen e ekosistemeve të shëndetshëm, minimizimin e ndotjes dhe mbeturinave, kufizimin e emetimeve të serrës dhe ofrimin e mallrave dhe shërbimeve të gjelbërta për të mundësuar modele më të përgjegjshme të konsumit, ato janë jetike për një model zhvillimi të qëndrueshëm. Për më tepër, biznesi i gjelbër vepron si një katalizator për sipërmarrësit për të dhënë një kontribut të konsiderueshëm socio-ekonomik, pasi këto biznese mbrojnë shëndetin e konsumatorëve dhe komuniteteve, gjenerojnë punë dhe sigurojnë burime të gjelbërta të nevojshme, duke stimuluar kështu rritjen e ekonomisë.

Krijimi dhe zhvillimi i bizneseve të gjelbërta, sjell me vete avantazhe të shumta si aksesimi në tregjet e reja pasi kërkesa për produkte jeshile është në rritje, ul kostot e biznesit falë masave të gjelbërimit në proceset e prodhimit dhe përmirësimin e produktivitetit të personelit të lidhur me vendet e gjelbërta të punës.

Në këtë kuadër si dhe në mbështetje të vizionit të Bashkisë Tiranë për një Tiranë të gjelbërt dhe të qëndrueshme, Bashkia e Tiranës e sheh biznesin e gjelbër si një zgjidhje winwin për të adresuar sfidat aktuale të zhvillimit. Projekti “Mbështetje Financiare (Grant) për biznese të gjelbërta” synon të ndihmojë sipërmarrësit e rinj që aspirojnë të krijojnë biznese të gjelbërta dhe ndërmarrjet ekzistuese që aplikojnë parimet e ekonomisë së gjelbër në prodhim produktesh dhe konsum lëndësh të para.

2. Qëllimi dhe Objektivat

Çfarë është Ekonomia “e Gjelbër”?

Programi i Kombeve të Bashkuara për Mjedisin (UNEP), e përkufizon **Ekonominë e “Gjelbër”** si një ekonomi që çon në përmirësimin e mirëqenies njerëzore dhe barazisë sociale, duke reduktuar ndjeshëm rreziqet mjedisore dhe menaxhuar burimet natyrore në mënyrë të qëndrueshme. Pra Ekonomia e “Gjelbër” është një ekonomi që shkarkon sasi të vogla karboni, përdor në mënyrë eficiente burimet dhe sjell një zhvillim gjithëpërfshirës në shoqëri. Nocioni i ekonomisë së gjelbër nuk zëvendëson zhvillimin e qëndrueshëm, por krijon një fokus të ri në ekonomi, investime, kapital dhe infrastrukturë, punësim dhe sjell edhe rezultate pozitive sociale e mjedisore.

Cfarë është biznes “i gjelbër”?

Një **biznes “i gjelbër”** ose një biznes i qëndrueshëm, është një ndërmarrje/kompani që ka ndikim minimal negativ, ose ndikim potencialisht pozitiv në mjedisin global ose lokal, komunitetin, shoqërinë dhe ekonominë. **"Going green"** do të thotë të ndjekësh njohuri dhe praktika që mund të çojnë në vendime dhe mënyra të jetesës më miqësore ndaj mjedisit dhe ekologjikisht të përgjegjshme, të cilat mund të ndihmojnë në mbrojtjen e mjedisit dhe të ruajnë burimet e tij natyrore për gjeneratat e tanishme dhe të ardhshme.

Koncepti “biznes i gjelbër” përbëhet nga dy elemente "biznes" dhe "i gjelbër". Si të gjithë bizneset e tjera edhe biznesi i gjelbër krijon të ardhura. Por "i gjelbër" do të thotë ta bësh këtë ndërkohë që shfrytëzon në mënyrë të qëndrueshme mundësitë që mban (ka) natyra, dhe pa dëmtuar mjedisin.

Biznesi i gjelbër mund të përcaktohet nga dy këndvështrime: njëra lidhet me ofrimin e produkteve ose shërbimeve të gjelbërta, ndërsa tjetra lidhet me procesin e veprimtarisë ekonomike. Kjo do të thotë që sipërmarrësit mund të hyjnë në sektorin e "gjelbër" të biznesit duke ofruar produkte ose shërbime miqësore me mjedisin ose përmes një procesi miqësor me mjedisin me ndihmën e teknologjive të pastra që zvogëlojnë çdo efekt negativ të biznesit.

Qëllimi i projektit

Qëllimi i këtij projekti është stimulimi dhe motivimi i sipërmarrësve për të filluar biznese të reja që janë miqësore me mjedisin, të dizenuara për të rritur qëndrueshmërinë mjedisore apo për të zhvilluar biznese që janë të vetëdijshëm për ndikimin e tyre në mjedis dhe për të ndërmarrë hapa jo vetëm për të zbutur dëmin që shkakton metoda dhe produktet e tyre të prodhimit, por për të punuar në mënyrë aktive drejt një planeti më të gjelbër.

Objektivat e projektit

- Të edukojë bizneset për qëndrueshmërinë në mjedisin e tyre rajonal dhe global në ruajtjen dhe kursimin e burimeve të matshme;
- Të mbështesi biznese në përpjekjet e tyre për të adoptuar mënyra të jetesës dhe praktika të biznesit më miqësore ndaj mjedisit;
- Të ndërtojë bashkësi të njerëzve që ndërmarrin veprime ndaj konsumit më të zgjuar, më miqësor ndaj mjedisit;
- Të përmirësojnë cilësinë e jetës përmes konsumit të mirë dhe ruajtjes së zakoneve, si dhe përfshirjes së

shtuar në komunitetin e tyre.

3. Përfitimet e projektit

Nuk ka dyshim që bizneset e gjelbërta janë mjaft të rëndësishme për shoqëritë prodhuese, të shëndetshme dhe të qëndrueshme. Duke qenë se bizneset e gjelbërta përdorin sasi të kufizuara (ose aspak) të lëndëve djegëse fosile dhe kanë të ulët (ose aspak) emetimet, ato mund të luajnë një rol kryesor në luftën kundër ndryshimit të klimës dhe kontribuojnë në rritjen dhe krijimin e vendeve të punës.

Përfitimet e biznesit të gjelbër përfshijnë hyrjen në tregjet e pashfrytëzuara, përmirësojnë efikasitetin e burimeve, kursim të kostove dhe përmirëojnë produktivitetin e stafit si rezultat i një ambienti pune më të pastër dhe më të sigurt.

Disa nga përfitimet e një biznesi të gjelbër:

Qasja në tregje: duke qenë se klientët gjithnjë e më shumë kërkojnë produkte miqësore me mjedisin për shkak të rritjes së vetëdijes eko, por edhe për arsye shëndetësore (siguri më e madhe të produkteve jo toksike) ose arsye financiare (kosto më e ulët operative);

Kursime: nga reduktimi i kostove, pasi konsumi i ujit, i energjisë dhe faturat e tjera zvogëlohen përdorimi i burimeve bëhet më efikas. Një biznes që zvogëlon kostot e tij materiale, kostot e energjisë, kostot e ujit si dhe kostot e tjera bëhet më efikas, më pak i kushtueshëm dhe më produktiv;

Qasja në mbështetje financiare ashtu edhe jo-financiare: pasi qeveritë i kushtojnë rëndësi gjithnjë e më të madhe sjelljes ndaj mjedisit;

Fuqi punëtore më e shëndetshme dhe produktive: aftësia e së cilës për të punuar nuk rrezikohet nga rreziqe shëndetësore siç janë toksinat në vendin e punës. Punëtorët në një biznes të gjelbër zakonisht do të kenë më pak probleme shëndetësore sesa ato në biznese të cilat përfshihen në procese që dëmtojnë mjedisin. Për shembull, në ndërmarrjet që përdorin kimikate toksike, ndotja e ajrit në ambiente të mbyllura mund të shkaktojë probleme të menjëhershme shëndetësore, ndikime shëndetësore afatgjata. Punëtorët do të jenë gjithashtu më produktivë sepse nuk do të shqetësohen në lidhje me rreziqet shëndetësore. Gjelbërimi i proceseve kështu mund të çojë në rritjen e produktivitetit të biznesit;

Një mjedis rrethues më i shëndetshëm: në të cilin ruhen burimet e nevojshme nga biznesi për të tashmen dhe të ardhmen. Duke gjelbëruar bizneset e tyre, sipërmarrësit kontribuojnë në mirëmbajtjen e një mjedisi në të cilin ata mund të ushtrojnë veprimtarinë e tyre me një bazë fitimprurëse edhe në të ardhmen.

4. Buxheti

Vlera e përgjithshme e fondit, për periudhën 2021-2023 do të jetë 36.000.000 (tridhjetë e gjashtë milionë) lekë. Vlera e fondit për secilin vit do të jetë 12.000.000 (dymbëdhjetë milion) lekë.

| Periudha | TOTAL |
|-----------|------------|
| Viti 2021 | 12.000.000 |
| Viti 2022 | 12.000.000 |
| Viti 2023 | 12.000.000 |

UDHËZUES OPERACIONAL

“Mbështetje financiare (Grant) për biznese të reja “të gjelbërta” të cilat bazohen në një model eko-miqësor, ose biznese ekzistuese të cilat tentojnë të shndërrohen në biznese “të gjelbërta” duke futur elementë go-green në to.”

Ky udhëzues përfshin të gjitha procedurat dhe dokumentacionin e detajuar të nevojshëm për të zbatuar në mënyrë profesionale dhe transparente Skemën e Grantit për Bizneset e Gjelbërta.

Udhëzuesi bazohet në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjin nr. 9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 513, datë 4.9.2018 “Për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe procedurat e dhënies dhe autorizimit të disa kategorive të ndihmës shtetërore”, Vendimin e Komisionit të Ndihmës Shtetërore nr. 99, datë 16.10.2020 “Autorizim i ndihmës shtetërore “Mbështetje financiare (Grant) për biznese të reja “të Gjelbërta”, të cilat bazohen në një model eko-miqësor, ose biznese ekzistuese të cilat tentojnë të shndërrohen në biznese të “Gjelbërta” duke futur elementë Go-Green në to”.

1. Çfarë është Granti për Bizneset e Gjelbërta?

Granti për bizneset e gjelbërta është një projekt i Bashkisë së Tiranës, i financuar nga burime publike (të parashikuara në zërin e buxhetit afatmesëm të Bashkisë Tiranës (2021- 2023) në Programin 04130 “Mbështetje për zhvillimin Ekonomik”, i projektuar për të mbështetur financiarisht (Grant) bizneset e reja “të gjelbërta”, të cilat bazohen në një model eko-miqësor, ose biznese ekzistuese të cilat tentojnë të shndërrohen në biznese “të gjelbërta”, duke futur elementë “Go-Green” në to.

Kjo skemë granti është hartuar për t’i shërbyer bizneseve të vogla dhe përgjithësisht start up-eve, por edhe bizneseve të vogla dhe të mesme ekzistuese.

Projekti synon të mbështesë financiarisht kategoritë si më poshtë:

- Biznese të reja që synojnë të prodhojnë produkte ekologjikisht miqësore, ofrojnë shërbime ose shfrytëzojnë procese që janë miqësore me mjedisin;
- Biznese ekzistuese me një qasje eko-miqësore;
- Biznese që kthejnë produktet e mbeturinave në materiale dhe energji të përdorshme;
- Biznese që shfrytëzojnë burime natyrore në komunitet;
- Bizneset të tilla si agrobiznes (prodhim, përpunim, tregtim) nëse përdorin praktikën e qëndrueshme të bujqësisë dhe i shesin prodhimet e tyre në nivel lokal;
- Biznese që përdorin materiale të ricikluara ose përdorin energji të rinovueshme ose të gjelbër në prodhimin e saj ose produkte që janë 100% të riciklueshëm;
- Biznese me ide inovative në krahasim me bizneset e tjera të cilët dalin me zgjidhje të reja për të adresuar problemet mjedisore.

2. Mbështetja financiare

Granti do të mbështesë biznese të reja apo ekzistuese të gjelbërta, për një afat kohor jo më shumë se sa një vit dhe në shumë deri në 500.000 (pesëqind mijë) lekë/ biznes. Inkurajohen bashkëfinancime nga burime alternative.

Skema do të rimbursojë kostot e miratuara në përputhje me udhëzimet e mëposhtme:

- Skema mbulon 80% të kostove të pranueshme brenda limitit të sipërpërmendur për sipërmarrjet e reja dhe ekzistuese, pjesa tjetër do të financohet nga vetë përfituesi i saj;
- Aplikanti duhet të ofrojë kontribut financiar të barabartë me të paktën 20 % të grantit të financuar të kërkuar;
- Pagesa e grantit të përfituar bëhet 50% në fillim të projektit me dorëzimin e një kopjeje të certifikatës së NIPT-it (si për bizneset e reja edhe ato ekzistuese) dhe 50% në përfundim të projektit, kundrejt faturës/faturave tatimore me TVSH ose faturave të thjeshta tatimore e cila/të cilat vërteton/vërtetojnë shpenzimet e kryera dhe dokumentave të tjera mbështetëse të cilat do të dorëzohen në përfundim të projektit;
- Granti nuk mund të jepet më shumë se një herë për të njëjtën sipërmarrje.

3. Aplikantët e pranueshëm

Kandidatët dhe pjesëmarrësit e pranueshëm të Projektit janë të gjithë individët shtetas shqiptarë mbi 18 vjeç, banorë të Bashkisë Tiranë, të cilët kanë një ide për të krijuar një biznes të gjelbër apo kanë një biznes ekzistues të vogël/të mesëm dhe kërkojnë të shndërrohen në biznese eco-friendly (miqësore ndaj mjedisit).

Individët apo bizneset që nuk përmbushin kriteret për t'u përzgjedhur, janë ata të cilët kanë një konflikt interesi me palët e përfshira dhe vendimmarrësit e Projektit, nuk kanë ide inovatore apo të qartë mbi ndërtimin e tij.

Çdo aplikant mund të marr pjesë me vetëm një ide biznesi. E drejta për të marrë pjesë në Projekt dhe për të pasur akses në asistencën e Grantit mund të përdoret vetëm një herë në vit.

Aplikimet nga bizneset ekzistuese do të pranohen nëse plotësohen kriteret e sipërpërmendura dhe nëse biznesi:

1. Është i regjistruar në Tiranë;
2. Nuk është në likuidim, falimentim apo procedurë për mbyllje;
3. Ka paguar të gjitha detyrimet ndaj tatimeve si dhe taksat dhe tarifat vendore.
4. Aplikime për bizneset e reja që do të krijohen do të pranohen nëse individët do të regjistrojnë biznesin e tyre në Tiranë brenda 15 ditëve pas nënshkrimit të kontratës me BT.

4. Shpenzimet që mund të mbulohen nga skema

4.1 Kostot e mbulueshme nga skema

Shpenzimet e pranueshme që mund të mbulohen nga paratë e grantit duhet të përdoren për zbatimin e planit të biznesit dhe mund të përfshijnë:

1. blerjen e materialeve për mobilim ose rregullim të mjediseve/godinave për biznesin;
2. blerjen e makinerive, mjeteve dhe pajisjeve, si edhe softëare dhe asete të tjera jo të prekshme të cilat do të shërbejnë për të diversifikuar prodhimin me produkte të reja të gjelbërta shtesë ose një ndryshim rrënjësor në procesin e përgjithshëm të prodhimit të këtyre produkteve ;
3. shpenzime për asete të tjera të paprekshme (licenca, markim dhe patentim produktesh);
4. krijimi i një faqeje interneti dhe publikimi ose reklamimi i aktiviteteve vetëm për 6 (gjashtë) muajt e parë të fillimit dhe nuk mund të tejkalojë më shumë se 10% të grantit total (si për njësitë e reja ekonomike edhe për ato ekzistuese);
5. pagat dhe sigurimet do të mbulohen vetëm për të punësuarit që lidhen drejtpërdrejt me procesin e prodhimit të produkteve të gjelbërta, deri në 3 muaj pas fillimit të biznesit, bazuar në rrogën minimale në Shqipëri (pjesa tjetër e rrogës duhet të mbulohet nga vetë biznesi).

4.2 Kostot e pambulueshme nga skema

Shpenzimet jo të pranueshme që nuk mund të mbulohen nga paratë e grantit përfshijnë:

1. kostot e lindura përpara nënshkrimit të kontratës së grantit pasi ai është miratuar.
2. blerjen e pasurive të patundshme (tokë, godina, etj.);
3. blerjen e mjeteve të transportit që nuk do të përdoren direkt për funksionimin e biznesit të propozuar;
4. çdo shpenzim që nuk lidhet me biznesin e propozuar;
5. aktivitete që mbështeten nga burime të palëve të treta;
6. zbavitje dhe dhurata;
7. shpenzime administrative.

Shpenzimet jo të pranueshme në grant mund të mbulohen nëpërmjet kontributit personal të aplikantit, dhe formave të tjera të financimit, siç janë kreditë, huaja, etj.

5. Mbulimi gjeografik

Projekti do të zbatohet në territorin e Bashkisë Tiranë, për tre vitet 2021-2023, të parashikuara në buxhet.

6. Organet e Projektit dhe detyrat e tyre

Projekti “Grant për biznese të gjelbërta” do të zbatohet nga Bashkia e Tiranës, Drejtoria e Përgjithshme e Projekteve Strategjike dhe Zhvillimit Ekonomik, nëpërmjet Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik Urban. Në projekt do të përfshihen në disa hapa konkretë të zbatimit dhe struktura të tjera të Bashkisë Tiranë, siç janë:

- Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licencimit;
- Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar.

Projekti do të zbatohet nga organet e mëposhtme:

- Komisioni i Aprovimit të Grantit (KAG)
- Grupi i Menaxhimit të Skemës së Grantit (GMSG)

Komisioni i Aprovimit të Grantit – bën vlerësimin e aplikimeve dhe akordimin e granteve për llogari të ndërmarrjeve përfituese.

Komisioni është përgjegjës për:

1. Vlerësimin e aplikimit;
2. Miratimin e grantit për aplikuesit e suksesshëm;
3. Miratimin e raportit përfundimtar të përfituesit;
4. Marrjen në shqyrtim të rasteve problematike me kërkesë të Grupi të Menaxhimit të Skemës së Grantit.

Komisioni i Aprovimit të Grantit përbëhet nga 3 anëtarë: Drejtori Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Projekteve Strategjike dhe Zhvillimit Ekonomik i cili është njëkohësisht dhe Kryetar i Komisionit të Aprovimit të Grantit, Drejtori i Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik Urban dhe një përfaqësues nga Drejtoria e Financës.

Vendimet e Komisionit janë të vlefshme vetëm kur janë prezent më shumë se gjysma e anëtarëve të komisionit dhe nënshkruhet prej tyre.

Grupi i menaxhimit të skemës – mban përgjegjësinë kryesore për implementimin dhe menaxhimin e kësaj skeme. Ai është përgjegjës për:

1. Kontrollimin e vlefshmërisë së aplikimeve;
2. Përgatitjen dhe sigurimin e të gjithë dokumentacionit të kërkuar nga KAG si dhe shpërndarjen e tij të paktën 1 ditë përpara mbledhjes të Komisionit;
3. Marrjen pjesë në mbledhjet e KAG, pa të drejtë vote, dhe hartimin e procesverbalit përkatës të mbledhjes, që i paraqitet për shqyrtim dhe vlerësim të mëtejshëm KAG-së;
4. Miratimin e raporteve përfundimtare të paraqitura nga përfituesit e granteve, të analizuara dhe kontrolluara si dhe kërkimin e informacioneve të tjera dhe/ ose dokumentacionit shtesë sa herë që e gjykon të nevojshme;
5. Mbajtjen e të dhënave në lidhje me zbatimin e Grantit;
6. Kontrollimin dhe aprovimin e të gjithë përgjigjeve zyrtare që do t'u dërgohen aplikantëve.

Grupi i Menaxhimit të Skemës së Grantit, në bazë të fushës së përgjegjesisë, përbëhet nga stafi i Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik Urban.

7. Mënyra e procedimit të Skemës së Grantit

7.1 Shpallja e grantit dhe dorëzimi i dokumentacionit

Thirrjet për shprehjen e interesit do të shpallen në faqen zyrtare të Bashkisë Tiranë, në stendën e Bashkisë Tiranë si dhe në median sociale.

Së bashku me thirrjen për propozim personat e interesuar apo bizneset, mund të marrin gjithashtu të gjithë informacionin përkatës mbi procedurën e aplikimit dhe dokumentet standarde të aplikimit.

Propozimet që do të dorëzohen duhet të përfshijnë dokumentat e mëposhtme:

1. Formularin e Aplikimit për Grantin e Gjelbërt;
2. Planin e Biznesit dhe të Financimit sipas modelit të kërkuar (certifikime/patenta , të tjera dokumenta suportues të cilat do të vërtetojnë për bizneset ekzistente dhe start up elementin eko miqësor);
3. Formularin e vetëdeklarimit;
4. Kopjen e kartës së identitetit;
5. Kopjen e ekstraktit të biznesit nga regjistri tregtar të lëshuar nga QKB për bizneset ekzistuese (nga e-albania);
6. Të gjithë aplikantët që synojnë të hapin një biznes të ri, kanë afat 15 ditë pas aprovimit të Grantit nga Komisioni i Aprovimit të Grantit dhe firmosjes së Kontratës për regjistrimin e biznesit të tyre pranë zyrave të QKB;
7. Vërtetim origjinal për llogari bankare në lekë për bizneset ekzistuese. Bizneset e reja do të sjellin llogarinë bankare pasi të jenë shpallur fitues dhe të jenë regjistruar në QKB.

Të gjithë aplikantët duhet t'i qëndrojnë në mënyrë rigoroze formatit të aplikimit dhe formateve të bashkëngjitura në këtë udhëzim.

Kërkesa së bashku me dokumentacionin e kërkuar për përfitimin e Grantit, do të paraqitet në sportelin e Bashkisë së Tiranës (SIQ) nga vetë kërkuuesi sipas formatit të aplikimit.

Punonjësi i SIQ do të asistojë të interesuarin në plotësimin e formularit të aplikimit, verifikon identitetin dhe kërkon nënshkrimin e formularit të plotësuar.

Dokumentat paraqiten në origjinal, në kopje të njësuara me të njëjtën fuqi provuese me origjinalin, nën përgjegjësinë e plotë të aplikantit për vërtetësinë e akteve të marra si kopje të vërteta të origjinalit.

Punonjësi i SIQ lëshon një konfirmim, me shkrim, për çdo kërkesë për aplikim.

Punonjësi i SIQ është i detyruar të marrë në dorëzim çdo aplikim, të paraqitur sipas dokumentacionit të përcaktuar.

Aplikimi do të pajiset me një numër reference (nr. Prot.) dhe do të regjistrohet në listën e aplikuesve të Fondit.

Përveç aplikimit në sportelin e Bashkisë së Tiranës (SIQ), aplikuesi për grantin duhet të paraqesë

elektronikisht Plan Biznesin dhe Planin e Financimit, në adresën e kontaktit: albana.valera@tirana.al.

Çdo aplikim i marrë pas datës përmbyllëse të shpallur do të konsiderohet i pavlefshëm.

Afati përfundimtar për dorëzimin e dokumentave të nevojshëm është **2 muaj**, që nga data e shpalljes së projektit. Ky afat shpallet qartësisht në të gjitha thirrjet publike (stendat e Bashkisë, faqen elektronike të Bashkisë, rrjetet sociale etj.).

7.2 Vlerësimi i dokumentacionit

Vlerësimi i dokumentacionit për kontrollin administrativ bëhet nga Grupi i Menaxhimit të Skemës dhe bazohet mbi këto elemente:

1. Respektimi i afateve;
2. Informacioni i kërkuar është i plotë dhe i saktë.
3. Nëse mungon ndonjë prej dokumentave të kërkuara, aplikuesi do të kontaktohet nga GMS së grantit dhe do të njoftohet për dokumentat që mungojnë.

Plotësimi i dokumentacionit të paplotë duhet të bëhet brenda 10 ditëve nga momenti i njoftimit të aplikuesit nga GMS.

Aplikimet që do të kalojnë fazën e kontrollit administrativ dhe verifikimin e kriteteve të kualifikimit, do t'i paraqiten për vlerësim Komisioni të Aprovimit të Grantit, nga GMS.

KAG mund të vendosë që të miratojë ose refuzojë aplikimin. Vendimi do të bazohet në dokumentacionin e paraqitur, duke marrë parasysh vlerësimin e bazuar në kriteret e paracaktuara të kualifikimit.

Vendimi për dhënien apo jo të Grantit, miratohet me shumicë votash dhe nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e KAG.

Pas mbledhjes dhe marrjes së vendimit nga KAG, bëhet njoftimi i përfituesve (shkresë zyrtare/email) në rast se:

1. *Kërkesa është refuzuar nga KAG duke listuar dhe arsyet e refuzimit;*
2. *Kërkesa është miratuar nga KAG.*

Nëse aplikantët kanë rezerva në lidhje me vendimarrjen, atëherë ata mund të ankohen pranë KAG, brenda 5 ditëve pune nga momenti i njoftimit.

Pas shqyrtimit të ankesave të ndryshme të aplikuesve dhe/ose pas përfundimit të afatit të ankimimit, KAG do të përcjellë proces verbalin me listën përfundimtare të përfituesve të fondit për konfirmim tek Kryetari i Bashkisë, brenda tre ditë pune.

8. Kontraktimi dhe mënyra e pagesës së Grantit

Pas njoftimit nga ana e Bashkisë Tiranë, përfituesit e Grantit, me asistencën e Drejtorisë së Përgjithshme Juridike të Aseteve dhe Licencimit, do të lidhin një Kontratë me Bashkinë Tiranë për

përfitimin e Grantit.

Financimi dhe pagesat do të kryhen në dy faza. Lëvrimi i pagesës do të bëhet në dy pjesë në përputhje me të gjitha shpenzimet e parashikuara dhe të paraqitura në pasqyrat financiare të planit të biznesit dhe financimit të miratuar nga KAG.

Pas nënshkrimit të kontratës, Drejtoria e Përgjithshme e Projekteve Strategjike dhe Zhvillimit Ekonomik përcjell me shkresë kontratat, certifikatat e NIPT-it dhe vërtetimet e llogarive bankare në Drejtorinë e Përgjithshme të Menaxhimit Financiar, e cila brenda 30 ditëve do të kryejë rimbursimin në vlerën 50%. Pjesa e dytë e pagesës do të lëvrohet në përfundim të implementimit të të gjithë projektit në përputhje me projekt - idenë dhe skemën e grantit të akorduar, duke dorëzuar fatura, kontrata apo dokumenta të tjera mbështetëse të cilat vërtetojnë këto shpenzime.

Shpenzimet e parakryera nuk do të njihen si investim por vetëm shpenzimet pas nënshkrimit të kontratës së grantit janë të vlefshme.

Përfituesit e fondeve nuk janë të autorizuar për kalimin e tyre tek palë të treta. Të gjithë detajet specifike mbi kohën dhe pagesat do të përcaktohen në marrëveshjen kontraktuale të grantit në përputhje me projektin dhe specifikat e tij.

9. Monitorimi i projektit

Menjeherë pas financimit, aplikantët duhet të fillojnë me implementimin e projektit të tyre bazuar në biznes-planin e dorëzuar gjatë fazës së aplikimit. Përfituesit janë të detyruar t'i paraqesin Bashkisë Tiranë në përfundim të projektit një raport përfundimtar mbi implementimin e projektit për të justifikuar të gjitha shpenzimet e kryera, duke paraqitur të gjithë faturat dhe dokumentacionin mbështetës për këto shpenzime.

Bashkia e Tiranës, nëpërmjet Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik Urban, do të kryejë monitorimin përkatës për çdo kontratë granti të nënshkruar dhe ka të drejtën të bëjnë inspektime në terren për të monitoruar, verifikuar apo dhe për të kërkuar dokumentacion shtesë për të vërtetuar të dhënat e raportura nga përfituesi i grantit.

I gjithë informacioni i mbledhur gjatë vizitave në terren do të reflektohet në një Proces Verbal.

10. Konfidencialiteti i të dhënave

Gjithë informacioni i dhënë nga aplikantët për BT për qëllim të Skemës, veçanërisht e gjithë korrespondenca e shkëmbyer është konfidenciale dhe nuk do të zbulohet. BT do të ruajë në mënyrë konfidenciale informacionet e marra nga ndërmarrjet.

Asnjë e dhënë e marrë prej BT nga ana e aplikuesve nuk do t'u bëhet e ditur palëve të treta pa miratimin e tyre.

Megjithatë, ndërmarrja duhet ta dijë se informacioni në lidhje me zbatimin e Skemës, në veçanti identifikimi i ndërmarrjeve të mbështetura, të dhënat e përgjithshme rreth buxhetit, financimit, veprimet e kryera, rezultatet e arritura, ndikimet dhe të tjera të ngjashme, mund të përdoren, të

publikohen ose shpërndahen nga BT pa ndonjë kufizim.

11. Anekset e projektit

Si pjesë e këtij udhëzuesi bashkëlidhen dokumentet standarte si vijon:

1. Njoftimi Publik
2. Formulari i aplikimit
3. Format vetëdeklarimit
4. Format plan biznesi dhe financimi
5. Kontrata Bashki- Përfitues Fondi
6. Kriteret e vlerësimit